



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER**  
**DREJTORIA E HARTIMIT TE POLITIKAVE DHE KONTROLLIT PER TAKSAT**  
**DHE TARIFAT VENDORE**

Nr. 6203 Prot.

Fier, më 23.05. 2025

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 52, datë 23.05. 2025

**Projekt Vendim :** “ Për shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Fier për Vitin 2025 “

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", gërma "f" i ndryshuar, të nenit 54; Ligjin Nr.9632. datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 5 gërma "c" i ndryshuar; Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat talimore në Republikën e Shqipërisë" indryshuar; Udhëzimin Nr.24. datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". të ndryshuar; Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore"; Ligjin Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 132, datë 07.03.2018 " Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar me VKM. Nr. 144. datë 13.02.2020; Ligjin Nr. 9975. datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Ligjit 10081, datë 23.02.2009 "Për Licensat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre"; Ligjin Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjin Nr.93/2015 "Për turizmin", Ligjin Nr.8098. datë 23.03.1996 "Për statusin e të verbërit" i ndryshuar, Ligji Nr.8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar. Ligjit Nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e Jetimit"; Ligjin Nr.9385. datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar. Ligjin Nr.10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", Ligjin Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Ligjin Nr. 10296 "Për manaxhimin financiar dhe kontrollin", Këshilli i Bashkisë Fier.VKB me nr.131 datë 26.11.2024," Mbi Strukturën dhe Nivelin e Taksave dhe Tarifave Vendore të Vitit 2025 .

**PROPOZJME:**

1. Të miratohet shtyrja e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për subjektet ekonomike deri më datë **30.06.2025** .

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Hartimit të Politikave dhe Kontrollit për Taksat dhe Tarifat Vendore dhe Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, Bashkia Fier
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar

*Drejtoria e hartimit të politikave dhe  
kontrollit për taksat dhe tarifat vendore*  
**Anisa Cjapi**

*Drejtoria e Financës Buxhetit dhe  
Kontabilitetit*  
**Pranvera Cina**

*Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe  
Hartimit të Kontratave*  
**Esmeralda Kapllanaj**

**KRYETAR**

**Amando Subashi**

**NË MUNGESË E ME URDHËR  
ZËVENDËSKRYETARI**  
**Suela Prifti**

